

**Ngjarja e organizuar nga INDEP-i dhe Kombet e Bashkuara do të sigurohen që zërat e Kosovës të dëgjohen në samitin global për të ardhmen e ushqimit**

*Mbi 30 prodhues, konsumatorë dhe ekspertë të tjerë morën pjesë në takimin për zhvillim të ideve për t'ua bërë sistemin ushqimor të Kosovës më të sigurt, më të fortë dhe më të qëndrueshëm*

Prishtinë, 13 korrik: Teksa sistemet ushqimore në mbarë botën vazhdojnë të rimëkëmben nga tronditja prej pandemisë COVID-19, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në partneritet me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT) dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), sot organizoi një diskutim ndërveprues për të siguruar inpute për samitin që do të mbahet në Nju Jork në muajin shtator. Kjo ngjarje e rëndësishme është duke u mbështetur në kontributin e njerëzve në të gjithë botën për të identifikuar zgjidhje të qëndrueshme për të ardhmen e ushqimit.

“INDEP-i është i përkushtuar ndaj promovimit të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm pikërisht në fushat e zvogëlimit të ndotjes, promovimit të qasjes në ushqim cilësor për të gjithë, dhe zvogëlimit të pabarazive. Ky bashkëbisedim global për sistemet ushqimore paraqet rastin ideal për të diskutuar si ta arrijmë këtë në Kosovë,” u shpreh Burim Ejupi, Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Politika Zhvillimore dhe organizator i ngjarjes së sotme.

Takimi mbledhi më shumë se 50 pjesëmarrës për një diskutim të gjallë dhe konstruktiv.

Në fjalën e tij hyrëse, Zëvendës Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Imri Demelezi ua përkujtoi pjesëmarrësve se një sistem ushqimor që funksionon mirë është me rëndësi jetike për shëndetin dhe mirëqenien e popullit të Kosovës.

Koordinatorja e OKB-së për Zhvillim Ulrika Richardson reflektoi mbi ushqimin si themel i jetës: “Ushqimi na bashkon si familje dhe komunitete, ndërkohë që mbështet vendet e punës. Por COVID-19 na i ka rikujtuar lidhjet e qarta mes pabarazisë, varfërisë, ushqimit dhe shëndetit. Duke punuar së bashku drejt transformimit të sistemit ushqimor të Kosovës, ne mund të fillojmë një zhvendosje drejt një bote më të sigurt, më të drejtë, më të qëndrueshme,” tha ajo.

Fermerët, prodhuesit dhe përpunuesit ushqimorë, pronarët e restoranteve, bankierët, ambientalistët e rinj dhe palët e tjera të interesit, ndanë një varg këndvështrimesh të ndryshme. Diskutimet u përqendruan në ofertën dhe kërkesën për ushqime të prodhuara në mënyrë të qëndrueshme, si dhe përdorimin qarkor të burimeve ushqimore për të minimizuar mbetjet ushqimore.

Pjesëmarrësit u dakorduan për disa mënyra se si mund të forcohet sistemi ushqimor në Kosovë. Këto përfshinin rëndësinë e matjes dhe integritet të “çmimeve të fshehura” të prodhimit të ushqimit dhe ushqimit të çuar dëm (siç janë shpenzimet mjedisore, ekologjike dhe shoqërore) dhe roli i cilësisë së infrastrukturës së transportit dhe magazinimit, si një element i rëndësishëm për të theksuar qasjen në tregje dhe ushqim cilësor për të gjithë. Diskutimet u shoqëruan nga moderatorë ekspertë nga INDEP, Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë, UNDP dhe UN-Habitat.

INDEP-i, së bashku me UNKT-në, do t'ua dorëzojnë rezultatet e takimit organizatorëve të Samitit për Sistemet Ushqimore në Nju Jork. “Kjo është mundësia jonë që ta kemi një vend në tryezë,” tha Dardan Abazi, i cili moderoi sesionin plenar përfundimtar ku u dhanë rekomandime. “Përmes kontributit tonë të përbashkët, do t'i bashkohemi një komuniteti global të njerëzve të përkushtuar ndaj transformimit të sistemeve ushqimore në mbarë botën.”

Për të mësuar më shumë rreth ngjarjest, vizitoni:

<https://www.facebook.com/events/331079605326415/?ti=ls>

### **Rreth Samitit të OKB-së për Sistemet Ushqimore 2021:**

Samiti i OKB-së për Sistemet Ushqimore u shpall nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, në *Ditën Botërore të Ushqimit* në tetor 2020 si pjesë e Dekadës për Veprim për arritjen e OZHQ-ve deri në vitin 2030. Qëllimi i Samitit është arritja e progresit në të gjitha 17 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm përmes një qasjeje të sistemeve ushqimore, duke shfrytëzuar ndërlidhjen e sistemeve ushqimore me sfidat globale si uria, ndryshimet klimatike, varfëria dhe pabarazia. Më shumë informata në lidhje me Samitin e OKB-së për Sistemet Ushqimore dhe listën e anëtarëve të Komitetit Këshillues dhe të Grupit Shkencor mund të gjeni këtu: <https://www.un.org/foodsystemssummit>.